

**STATUT  
I SHOQERISE " INVESTMENTWINGS " sh.p.k.**

**KAPITULLI 1**

**Dispozita te Pergjitheshme**

Shoqeria me pernjegjesi te kufizuar "**INVESTMENTWINGS**" sh.p.k., eshte themeluar sipas akt themelimit dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruara nga ortaku i saj bazuar ne "Ligin" Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "**Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare**" (*I ndryshuar*);

**KREU I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**NENI 1  
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 03/11/2023 une themeluesi kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Shoqeria do te emerohet "**INVESTMENTWINGS**" sh.p.k.

Themeluesi i shoqërisë është:

- Saif Ahmad Saif Belhasa, lindur më 01/01/1963, lindur në Dubai, madhor dhe me zotesi per te vepruar, identifikuar me Pasaporte me nr. AA0138293, leshuar nga Emiratet e Bashkuara Arabe.

**NENI 2  
Objekti i Shoqerise**

Shoqeria "**INVESTMENTWINGS**" sh.p.k. do te kete si objekt:

- Ushtrimin e aktivitetit per investime te cdo lloji, ne fushen e industrise bujqesore, kimike, biologjike, investim ne fushen e Arsimit, Avacionit, Informatikes, Ndertimit, Finances, Shendetese Mjekesore, Prodhim Medikamentesh, Konsulence, Agjensi Imobiliare, Shitblerje, import-eksport; media-gazetari-televizion-radio, linja ajerore; nxjerrje dhe perpunim mineralesh; nfate dhe gaz, panele diellore, investim ne fushen energjitikes , zhvillim aktiviteti ne sistemin bankar, exchange dhe institucionale financiare
- Ushtrimin e aktivitetit per ndërtim objektesh shumë katëshe, rezidenciale, rrugësh, rikonstruksione, ndërtim hekurudhe dhe metroje, punime hidraulike, elektrike, punime gipsi, suvatime, sisteme ngrohje-ftohje etj;
- Ushtrimin e aktivitetit shitje-blerje, objekte industrial, materiale elektrike dhe hidarulike, social-kulturore, bujqesore, turistike, hoteleri, ujesjellesa, punime restaurime dhe rikonstrukioni, punime te dheut, murature, punime betoni, punime te shembjes, kompletimin me instalime te brendshme te objekteve te ndertuara, marrjen dhe dhenien me qira te pajisjeve te ndertimit, te mjeteve te transportit per ndërtim dhe tregetim te tyre. Furnizim, vendosje, sherbime, furnizim-montim panele diellore.
- Importim, eksportim dhe tregetimin e te gjithave llojeve te materialeve, automjeteve me goma dhe zinxhire te tipeve te ndryshme te makinerive, pajisjeve dhe impianteve te ndryshme te karakterit public, industrial, bujqesor, tregetar, kulturor, sportive te sherbimeve. Ndertimi i kapanoneve industriale dhe bujqesore te te gjitha llojeve;



- Prodhim dhe Tregetim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial, produkteve bujqesore, ushqimore, materiale ndertimi, elektrike, hidraulike, sisteme ngrohje ftohje dhe materiale te sistemit te mbrojtjes nga zjarri, pesticidet, pajisje elektronike, konfeksione
- Grumbullimi dhe depozitimi i materialeve inerte ndertimore jo te rezikshme.
- Ne fushen e trgetise, import-eksport te mallrave dhe pajisjeve industrial, makinerive, automjeteve e aggregateve te industries Agro dhe Agro-Ushqimore.
- Projektim rrugesh te te gjitha niveleve, ura, tunele, nentalime, autostrada, trase hekurudhere mbi dhe nentoke, portesh, aeroportesh, heliportesh; projektim linjash dhe sistemesh se prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike: Projektim vepra naftesjelles, gasjelles, etj;
- Cdo aktivitet tjeter te nevojshem per realizimin e qellimit te Shoqerise.
- Tregtim dhe shitje me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshme elektrike, hidraulike, elektronike, ndertimi, makineri, automjete zjarrfikese e paisje per stervitje. Mirëmbajtja dhe instalimi i sistemeve per sigurinë nga zjarri dhe shpetimin. Kolaudime, riparime, mbushje dhe sherbime te paisjeve dhe mjeteve per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin. Trajnine dhe kurse profesionale per çdo punonjes ne fushen e sigurise teknike, sigurise dhe shendetit ne pune, mbrojtjes nga zjarri, perdorimin e pajisjeve dhe mjeteve zjarrfikese. Ofrim konsulencë menaxhimi dhe hartimi i dokumentit te vleresimit te riskut per çdo pozicion pune. Ofrime sherbimesh dhe keshillime per krijimin e sistemit parandalues nga rreziku i renies se zjarrit dhe planin e evakuimit. Keshilla dhe sherbime te jashtme te specializuara, sherbime shendetesore, mjeksia e punes, ergonomia, higjena industriale, aspekte psiko-sociale te punes dhe dhenia e ndihmes se pare. Tregti te mjeteve dhe veshjeve te punes dhe te veshjeve per mbrojtjen nga zjarri.

### NENI 3

#### **Adresa e Shoqerise**

Shoqeria do te kete Seline e saj në Tirane, Kastrati Rezidence, Godina B2, kati 3, Sheshi Italia.

Selia e shoqerise mund te transferohet.

### NENI 4

#### **Kohezgjatja e Shoqerise**

Kohezgjatja e Shoqerise eshte per nje periudhe te pakufizuar ,periudhe e cila mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Ortakeve.

### **KREU II**

#### **Kapitali**

### NENI 5

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar per vazhdimin e aktivitetit te shoqerise është në vlerën 1,000,000 (nje million) EURO, ekuivalente e vleres prej 105,300,000 LEK, qe i takon ortakut themelues si me poshte:

- **Ortaku z. Saif Ahmad Saif Belhasa:** Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 1,000,000 (nje million) EURO, ekuivalente e vleres prej 105,300,000 LEK, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### NENI 6

#### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Mbledhja e asamblese se ortakeve eshte organi vendimmarres per rritjen dhe zvogelimin e kapitalit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë, por vete ortaku pranon rivlersimin e pjeses se tij takuese ne shoqeri ne porpcion me rritjen e kapitalit.

Zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## NENI 7 Transferimi i kapitalit

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë në çdo kohë, me një vendim unanim, për transferimin e kuotave përmes shitjes, dhurimit apo ndonjë mënyre tjeter të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Për çdo formë të transferimit të kuotave (duke përfshirë edhe transferimin pa kundërshtpërbirim), ortakët ekzistues të Shoqërisë gjëzojnë të drejtën e parablerjes mbi kuotat e projektuara për t'u transferuar, në përputhje me rregullat e parashikuara në dispozitat në vijim (“**E Drejta e Parablerjes**”).

Ortaku, që ka për qëllim të shesë apo të transferojë kuotën e tij, duhet të njoftojë me shkrim (“**Njoftimi**”) Administratorin në adresën e selisë së Shoqërisë. Njoftimi duhet të përbajë të dhënët e Ortakut që ofron kuotën dhe të përfituesit të mundshëm të saj, kuotën që do të transferohet, kushtet e transferimit, duke përfshire çmimin dhe mënyrat e pagesës.

Administratori brenda 7 (*shtatë*) ditësh nga marrja e Njoftimit për transferimin, do të njoftojë Ortakun/et e Shoqërisë në lidhje me transferimin në fjalë.

Ortakët, të cilëve ju drejtohet Njoftimi si më sipër, duhet të ushtrojnë të drejtën e parablerjes mbi kuotën së cilës i referohet Njoftimi, duke i dërguar Ortakut ofrues dhe Administratorit brenda 30 (*tridhjetë*) ditësh nga marrja e Njoftimit, deklaratën e ushtrimit të së drejtës së parablerjes.

Në rast se Ortakët e tjerë dhe Ortaku transferues nuk bien dakord me çmimin e kuotës së propozuar nga ky i fundit për tu transferuar, apo me vlerën e tregut në rastin e transferimit të kuotës pa kundërshtpërbirim, ata do të caktojnë një ekspert të pavarur nga ortakët për të përcaktuar çmimin sipas vlerës se tregut, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Pas njoftimit të çmimit të kuotës të përcaktuar nga eksperti, ortakët brenda 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditësh duhet të njoftojnë Administratorin dhe ortakun transferues lidhur me interesimin e tyre për të blerë kuotën me çmimin e përcaktuar nga eksperti.

Nëse asnjë nga Ortakët nuk ka për qëllim të blejë kuotën e ofruar sipas mënyrave dhe kushteve të përshkruara ose në rast se askush prej Ortakeve nuk njofton brenda 30 (*tridhjetë*) ditëve, Ortaku transferues do të jetë i lirë të transferoje kuotën e tij te blerësit të përcaktuar në Njoftimin dërguar Ortakeve të tjerë.

Transferimi do të konsiderohet si i miratuar në heshtje nëse Ortakut transferues nuk i paraqitet asnjë njoftim për ushtrimin e së drejtës së parablerjes brenda 30 (*tridhjetë*) ditësh, ose kur nuk është arritur asnjë marrëveshje brenda gjashtëdhjetë 60 (*gjashtëdhjetë*) ditëve nga data e njoftimit të transferimit në fjalë nga Ortaku transferues.

E Drejta e Parablerjes duhet të ushtrohet për të gjithë kuotën e ofruar.

Asnjë Ortak nuk mund të vendosë mbi kuotat ndonjë peng, garanci, hipotekë apo çdo lloj barre tjeter apo t'i vendos si objekt i një të drejte për t'i barrësuar pa marrë më parë miratimin më shkrim të Ortakut tjeter.



Asnjë Ortak nuk do të bëhet palë e një marrëveshje në lidhje me të drejtën e votës që lidhet me kuotën e tij apo të interesave të tjera që zotëron në Shoqëri.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**  
**NENI 8**  
**Organí Vendimmarres**

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e me poshteme:

- 1- Asambleja e Ortakeve Te Shoqerise
- 2- Administratori

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme ne perputhje me nenin 10 dhe 11 te statutit:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë dhe shperndarja e fitimit/humbjes vjetore;
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- l)çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaket mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, nga një person i tretë me autorizimin perkates. Administrastoret e shoqerise nuk mund te vepojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

**NENI 9**  
**Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrat datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

**NENI 10**  
**Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 75% për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se tre te katertat ose 75% te numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **NENI 11** **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me 75% ose me 2/3 e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës ceshtjet e meposhteme:

1. për ndryshimin e statutit
2. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar
3. shpërndarjen e fitimeve
4. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, sipas nenit 10 pika 1, për çështje te tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### **NENI 12** **Përjashtimi nga e drejta e votes**

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:  
a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;  
b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;  
c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;  
ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

### **NENI 13** **Administrimi**

1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë per nje afat 5 vjecar nga data e regjitrimit te kesaj shoqerie prane QKB-se dhe do te veproj me tagra te pakufizuara:

- Shemsi Kebej, i datelindjes 01/07/1971, lindur ne Diber, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar me Leternoftim ID me nr. Personal. H10701070O, i cili ne te



njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithe veprimtarine e shoqerise ne menyre te pavarur.

#### **NENI 14** **Kompetencat e Administratorëve**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të veproje me tagra te pakufizuara për të:

- a) kryere të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësuar shoqërinë tregtare, te nenshkruajne kontrata apo cdo lloj akti tjeter te domosdoshem qe lidhet me aktivitetin e shoqeriser pa kufizim;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përrapa asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënët e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përrapa asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret se bashku ose ne menyre te pavarur nga njeri-tjetri jane te detyruar te therrasi Asamblee e Pergjitheshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administrator/in/ët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **NENI 15** **Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Cdo veprim i administratorit jashte tagrave te tij te shprehura specifisht ne ligj dhe/ose ne kete statut eshte i pavlefshem.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

1.) administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdës;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **NENI 16 Procedurat**

**1.** Votimi eshte procesi me kryesor i vendimarjes se veprimeve nga ana e ortakeve te shoqerise. Eshte e detyrueshme pjesemarrja e cdo ortaku duke dhene mendimin e tij: po, jo, abstenim

**2.** Cdo ortak ka te drejten hedhjes se një ceshtjeje per votim si dhe te mbrojtjes dhe te analizimit te vendimit te tij.

**3.** Cdo ortak i shoqerise ka te drejten e një vote.

**4.** Procedura e votimit percaktohet dhe drejtohet vetem nga ortaket e shoqerise me miratimin qe me pare te dy ose me shume anetareve te tjere te ortakeve te shoqerise.

**5.** Votimi merr vleren aktive vetem kur nga numerimi, rezulton se me shume se 2/3 e votave perkrahin ose hedhin poshtë temen e dhene per shqyrtim.

**6.** Cdo votim nuk mund te zgjase me shume se tre dite. Ne qofte se pjesemarrja brenda afatit nuk kalon 2/3 e anetareve aktive te ortakeve te shoqerise, me miratim ose shtyhet edhe 2 dite te tjera afati.

**Kreu V  
Viti finanziar-ekspertet**

#### **NENI 17 Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

#### **NENI 18**



## **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithvejetor dhe ate ne lidhje me kontrolllet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrolllet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

## **Kreu VI**

### **Prishja–riorganizimi i shoqërisë**

#### **NENI 19**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shnuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërise tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **NENI 20**

##### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

#### **NENI 21**

##### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqipërisë.

#### **NENI 22**

##### **Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

Ky Statut eshte i pergatitur ne dy (2) kopje te barazvlefshme ne gjuhen shqipe.

**ORTAKU I SHOQERISE**

**Saif Ahmad Saif Belhassa**

